



Progetto co-finanziato dall'Unione Europea



MINISTERO
DELL'INTERNO

FONDO ASILO, MIGRAZIONE E INTEGRAZIONE (FAMI) 2014-2020
OS 2 integrazione e migrazione legale - ON 2 integrazione - prog. n. 2574

QUESTIONARIO SUGLI STILI E LE MODALITÀ DI APPRENDIMENTO DELLA LINGUA STRANIERA PER RAGAZZI E ADULTI

ALBANESE



PYETËSOR PËR STILET DHE MODALITETET E TË MËSUARIT TË GJUHËS SË HUAJ

Version i adaptuar nga learningpaths.org

Ky pyetësor do të shërbejë për të kuptuar më mirë mënyrën tënde për të nxënë një gjuhë të huaj dhe preferencat tuaja në lidhje me studimin e saj.

Pohimet e mëposhtme përshkruajnë disa zakone studimi dhe disa mënyra të mësuarit që janë tipike për ata që studiojnë një gjuhë të huaj. Vendos se në çfarë mase zbatohet dhe cila fjali pohuese aplikohet në rastin tënd: rretho numrin që korrespondon me kolonën e zgjedhur. Për shembull, në qoftë se te pyetja 1 do të përgjigjesh *Rrallëherë*, rretho numrin 3.

Mundohu të jesh sa më i sinqertë: mos zgjidh përgjigjen që mendon se *do të ishte e drejtë* të japësh, por atë që *në të vërtetë* përshkruan më mirë zakonet tuaja personale. Duhet të kesh parasysh se *nuk ka përgjigje të drejta apo të gabuara* në këtë pyetësor. Qëllimi është vetëm që të ndihmojë të kuptosh më mirë mënyrën tënde personale e të mësuarit.

	<i>Shumë shpesh</i>	<i>Shpesh</i>	<i>Nganjëherë</i>	<i>Rrallëherë</i>	<i>Pothuajse kurrë</i>
1. Kur lexoj një tekst në gjuhë të huaj kam nevojë të kuptoj çdo fjalë.	0	1	2	3	4
2. Më përpara preferoj të shoh shumë shembuj dhe pastaj arrij të kuptoj rregullin gramatikor.	4	3	2	1	0
3. Për të kuptuar ose për të folur gjuhën e huaj kam tendencë të kaloj më përpara nga gjuha ime amtare.	0	1	2	3	4
4. I jap më shumë rëndësi fjalëve sesa gramatikës.	4	3	2	1	0
5. Acarohem nëse nuk kuptoj mirë një rregull ose cili është kuptimi i saktë i një fjale.	0	1	2	3	4
6. Kur lexoj sforcohem të marr vesh kuptimin e fjalëve të panjohura duke vrojtuar fjalët e tjera që janë afër tyre.	4	3	2	1	0
7. Preferoj që një rregull të më shpjegohet qartë, përpara se ta aplikoj atë në ushtrimet me shkrim ose me gojë.	0	1	2	3	4
8. Kur lexoj ose dëgjoj një tekst në një gjuhë të huaj nuk ka rëndësi për mua të kuptoj çdo fjalë menjëherë, por më mjafton të kuptoj idenë kryesore.	4	3	2	1	0
9. Kur flas në një gjuhë të huaj kam nevojë për njëfarë kohe për të përgatitur atë që dua të them.	0	1	2	3	4
10. Në mënyrë që të shpreh atë që dua të them me çdo kusht, rrezikoj të përdor struktura apo fjalë të reja ose më të vështira.	4	3	2	1	0
11. Kur flas në një gjuhë të huaj mundohem të korrigjohem menjëherë porsa e kuptoj se kam bërë një gabim.	0	1	2	3	4
12. Filloj menjëherë të flas ose të shkruaj pa i ndërtuar më përpara me mend fjalitë.	4	3	2	1	0
13. I mbaj mend gjërat më shumë kur studioj vetëm.	0	1	2	3	4


14. Më pëlqen të punoj me mësuesin dhe me të gjithë klasën.	4	3	2	1	0
15. Mësoj më shumë në shtëpi vetëm sesa në klasë.	0	1	2	3	4
16. Në klasë më pëlqen të punoj çift (dy e nga dy), ose në grup.	4	3	2	1	0
17. Preferoj ta lexoj një tekst sesa vetëm ta dëgjoj.	4	3	2	1	0
18. I kuptoj udhëzimet më mirë nëse i shoh të shkruara.	4	3	2	1	0
19. Kam nevojë të shkruaj menjëherë në fletore atë që po mësoj.	4	3	2	1	0
20. Për të mësuar fjalë të reja më duhet t'i shkruaj disa herë.	4	3	2	1	0
21. Më ndihmon të mbaj shënime për gjërat që thuhet në klasë.	4	3	2	1	0
22. Preferoj më mirë të shikoj një video sesa të lexoj një tekst.	4	3	2	1	0
23. Kur lexoj një tekst është e dobishme për mua që të nënvizoj pjesët e ndryshme, me ngjyra të ndryshme.	4	3	2	1	0
24. Ndjek më mirë udhëzimet e shkruara nëse ato paraqiten me një skemë ose vizatim.	4	3	2	1	0
25. Kur punoj në një tekst mësoj më shumë duke parë më përpara fotografitë ose ilustrimet.	4	3	2	1	0
26. Për të mësuar fjalë të reja më duhet t'i shoqëroj me figura.	4	3	2	1	0
27. Për të mësuar fjalët, kam nevojë t'i përsëris me zë të lartë ose me mend disa herë.	4	3	2	1	0
28. Më pëlqen të bëj ushtrime shqiptimi.	4	3	2	1	0
29. Mësoj shumë nga bisedat dhe diskutimet në klasë.	4	3	2	1	0
30. Më kujtohet më mirë ajo që kam dëgjuar në klasë sesa ajo që lexoj në një libër.	4	3	2	1	0
31. Mësoj shumë duke dëgjuar tekste në gjuhë të huaj (dialogë të regjistruar, njoftime, radio, këngë, etj.).	4	3	2	1	0
32. Nëse nuk arrij të shpjegoj mirë diçka, flas me gjeste.	4	3	2	1	0
33. Më pëlqen të bëj aktivitete manuale ose krijuese në shkollë.	4	3	2	1	0
34. Më pëlqen të bëj kërkime, të punoj në bibliotekë, në laborator, etj.	4	3	2	1	0

35. Më pëlqejnë lojërat, të imitoj episode të ndryshme, këngët dhe aktivitetet e tjera të ngjashme.	4	3	2	1	0
36. Më pëlqejnë aktivitetet ku më duhet të kërkoj informacione, të bëj intervista, të vizitoj vende të ndryshme, etj.	4	3	2	1	0


LLOGARITJA E PIKËVE

Mblidh numrat që ke rrethuar për çdo seksion të pyetësorit duke nxjerrë shumën (Pyetjet 1-8, 9-12, 13-16, 17-21, 22-26, 27-31, 32-36) dhe paraqit rezultatet e tua në shkallët e ndara përkatëse. Nuk ka rezultate pikësh më të mira ose më të këqija në këtë pyetësor. Çdo rezultat pikësh paraqet mënyrën *tënde personale* të studimit dhe të mësuarit. Çdo rezultat pikësh i referohet një stili të mësuarit dhe secili stil i të nxënimit mund të ketë anët e tij pozitive dhe negative.


Pyetjet 1-8



Pyetjet 9-12



Pyetjet 13-16



Pyetjet 17-21: Modaliteti viziv verbal -----|-----

Pyetjet 22-26: Modaliteti viziv jo verbal -----|-----

Pyetjet 27-31: Modaliteti dëgjimor -----|-----

Pyetjet 32-36: Modaliteti cinestetik -----|-----

0 2 4 6 8 10 12 14 16 18 20

SHKALLËT: PËRSHKRIMET DHE SUGJERIMET

Shkalla ANALITIKE/GLOBALE (Pyetjet 1-8)

Sa më shumë që rezultati i pikëve i afrohet numrit 0, aq më tepër je i prirë për të analizuar në detaje gjuhën që po mëson; ke tendencë t'i japësh shumë rëndësi gramatikës, kuptimeve të sakta të fjalëve, ushtrimeve që shërbejnë për t'u bërë korrekt në përdorimin e gjuhës; ndoshta i referohesh shpesh përkthimit për të qenë i sigurt që të mos e humbasësh kontrollin e strukturave dhe të fjalëve.

Këshilla: *Mundohu të mbash mend se, megjithëse gjuha e huaj mund të analizohet në strukturat e saj dhe në fjalorin e saj, jo gjithmonë është e mundur që të përvetësohen menjëherë rregullat dhe të përdoren ato për të kuptuar dhe për t'u shprehur. Ndonjëherë është më e dobishme të përqijemi të bëjmë hipoteza dhe të imagjinojmë kuptimin e asaj që dëgjojmë ose lexojmë dhe ndoshta të jemi të kënaqur duke mos kuptuar gjithçka menjëherë ose duke u shprehur jo gjithmonë në mënyrë 100% saktë.*

Sa më afër që rezultati i pikëve tuaja i afrohet numrit 16, aq më shumë ke një stil të "ekuilibruar" të mësuar ndërmjet atij analitik dhe global. Shumë persona, në fakt, e gjejnë veten në një pozicion të ndërmjetëm dhe shfrytëzojnë të dy stilet sipas nevojës.

Këshilla: *Sidoqoftë lexo përshkrimet e të dy stileve këtu sipër dhe këtu poshtë. Ndoshta mund të zbulosh se je më afër njërit ose tjetrit dhe kjo mund të të ndihmojë për të përmirësuar disa aspekte të mënyrës sate të mësimin të gjuhës suaj.*

Sa më shumë që rezultati i pikëve i afrohet numrit 32, aq më shumë ke prirje për të asimiluar gjuhën e huaj duke dëgjuar ose lexuar, pa pasur nevojë të mendosh shumë për gramatikën ose kuptimin e saktë të fjalëve. Ke tendencë t'i japësh më shumë rëndësi fjalëve, me të cilat e ndjen se mund të shprehesh, sesa strukturave gramatikore dhe ndoshta nënvlerëson rregullat në dëm të korrektësisë sate.

Këshilla: *Mundohu t'i kushtosh pak më shumë vëmendje korrektësisë gramatikore, saktësisë së fjalorit dhe shqiptimit. Edhe pse është e vërtetë që në disa situata mund të shprehemi dhe të kuptohemi pa qenë shumë korrekt, në shumicën e rasteve korrektësia favorizon të kuptuarit.*

Shkalla REFLEKSIVE/IMPULSIVE (Pyetjet 9-12)

Sa më shumë që rezultati yt i pikëve i afrohet numrit 0, aq më shumë ndien nevojën të mendosh përpara se të përdorësh gjuhën e huaj. Duhet të shmangësh rreziqet që mund të ndeshësh duke përdorur struktura ose fjalë për të cilat nuk je shumë i sigurt. Do të doje të kishe më shumë kohë në dispozicion për të përgatitur atë që dëshiron të thuash dhe ke tendencë të korrigjosh veten menjëherë pasi të kesh kuptuar se ke bërë një gabim.

Këshilla: *Nuk është e mundur të presësh të njohësh mirë të gjithë gramatikën dhe fjalorin e një gjuhe përpara se të "hidhesh" në përdorimin e saj! Përpiku të flasësh dhe të shkruash në gjuhë të huaj më shpesh, edhe nëse nuk e ndjen se je "i gatshëm" ashtu siç do të dëshiroje. Mëso të jesh pak më "aventuresk" kur shprehesh duke përdorur atë që me siguri tashmë e di.*

Sa më shumë që rezultati yt i pikëve i afrohet numrit 8, aq më shumë ke një stil të "ekuilibruar" të mësuar ndërmjet atij refleksiv dhe impulsiv. Shumë persona, në fakt, e gjejnë veten në një pozicion të ndërmjetëm dhe shfrytëzojnë të dy stilet sipas nevojës.

Këshilla: *Sidoqoftë, lexo përshkrimet e të dy stileve këtu sipër dhe këtu poshtë. Ndoshta mund të zbulosh se je më afër njërit ose tjetrit dhe kjo mund të të ndihmojë për të përmirësuar mënyrën tënde të mësimin.*

Sa më shumë që rezultati yt i pikëve i afrohet numrit 16, aq më shumë ke tendencë të shprehësh gjithçka që dëshiron në gjuhën e huaj, pa u shqetësuar se "si" e shpreh atë. Mendon se reflektimi mbi formën të prish spontanitetin dhe preferon të rrezikosh të bësh gabime në mënyrë që gjithsesi të mund t'ia dalësh në krye.

Këshilla: Është e drejtë të rrezikosh, por mund të jetë e rrezikshme të rrezikosh tepër në mënyrë të pamatur! Mundohu të kontrollosh më mirë jo vetëm "përmbajtjen" por edhe "formën" e asaj që dëshiron të thuash dhe nganjëherë ndalu dhe mendo se si mund të shprehesh në mënyrë më të qartë dhe të saktë.

Shkalla INDIVIDUALE/ E GRUPIT (Pyetjet 13-16)

Sa më shumë që rezultati yt i pikëve i afrohet numrit 0, aq më shumë ke tendencë të punosh mirë vetëm dhe preferon më shumë një studim individual sesa aktivitetet në grup. Ndoshta mëson më mirë duke studiuar vetëm, mbi një libër, sesa duke punuar me të tjerët.

Këshilla: Krahasimi me mësuesin dhe me shokët e klasës mund të jetë shumë i dobishëm, nuk e heq stilin tënd personal të punës, por gjithashtu të jep mundësinë të njohësh mendime të tjera, mënyra të tjera të menduari dhe të vepruari.

Sa më shumë që rezultati yt i pikëve i afrohet numrit 8, aq më shumë ke një stil të "balancuar" të mësuar ndërmjet punës individuale dhe punës në grup. Shumë persona, në fakt, e gjejnë veten në një pozicion të ndërmjetëm dhe shfrytëzojnë të dy stilet sipas nevojës.

Këshilla: Sidoqoftë, lexo përshkrimet e të dy stileve këtu sipër dhe këtu poshtë. Ndoshta mund të zbulosh se je më afër njërit ose tjetrit dhe kjo mund të të ndihmojë për të përmirësuar mënyrën tënde të mësimit.

Sa më shumë që rezultati yt i pikëve i afrohet numrit 16, aq më shumë ke tendencë të punosh më mirë në çifte ose në grup sesa vetëm, duke diskutuar me të tjerët në vend që të studiosh mbi libra për llogarinë tënde.

Këshilla: Krahasimi me të tjerët është padyshim i vlefshëm, por studimi individual është po aq i rëndësishëm për të ripërpunuar në mënyrë personale atë që po mëson.

Shkalla e MODALITETI VIZIV VERBAL (Pyetjet 17-21)

Sa më i lartë është rezultati i pikëve tuaja, aq më shumë preferon të lexosh atë që duhet të mësosh: për ty është e dobishme, për shembull, të lexosh udhëzimet e një detyre sesa thjesht t'i dëgjosh ato, të marrësh shënime për atë që thuhet në klasë, të shohësh gjërat e shkruara në tabelën e zezë, të studiosh më mirë me libra sesa të dëgjosh një leksion, të shohësh një video etj.

Shkalla e MODALITETIT VIZIV JO VERBAL (Pyetjet 22-26)

Sa më i lartë të jetë rezultati i pikëve tuaja, aq më shumë preferon të shohësh atë që duhet të mësosh: për shembull është e dobishme për ty t'i shoqërosh fjalët me figurat, të nënvizosh me ngjyra të ndryshme fjalët kyçe të një teksti, të bësh skema ose spidergram-e të asaj që duhet të mësosh, të ndërtosh imazhe mendore të fjalëve të reja për të mbajtur mend, të shikosh një video më shumë sesa të përdorësh një tekst të shkruar.

Shkalla e MODALITETIT DËGJIMOR (Pyetjet 27-31)

Sa më i lartë të jetë rezultati i pikëve tuaja, aq më shumë preferon të dëgjosh atë që duhet të mësosh: për shembull, është e dobishme për ty, të dëgjosh udhëzime dhe shpjegime, të lexosh me zë të lartë ose të përsëritësh fjalët me mend, të bësh ushtrime shqiptimi, të dëgjosh tekste në një gjuhë të huaj, të marrësh pjesë në diskutime dhe biseda në klasë etj.

Shkalla e MODALITETIT CINESTETIK (Pyetjet 32-36)

Sa më i lartë është rezultati i pikëve tuaja, aq më shumë preferon të kryesh aktivitete konkrete që përfshijnë lëvizje fizike: të marrësh pjesë në lojëra dhe episode, të përdorësh gjeste gjatë bisedës, të kesh përvoja aktive brenda dhe jashtë shkollës, si kërkime, intervista, aktivitete laboratorike e kështu me radhë.

A KE NJË REZULTAT PIKËSH “TË BALANCUAR” NË NJË OSE MË SHUMË MODALITETE?

Shumë veta mësojnë në mënyra të ndryshme, në varësi të situatave, dhe secili modalitet ka avantazhet e veta. Mundohu të shfrytëzosh sa më shumë anët pozitive të modaliteteve tuaja të preferuara, por gjithashtu përpiqu, me aq sa është e mundur, të mësosh se si të përdorësh modalitete të tjera: të dish të përdorësh shumë instrumente është gjithmonë më mirë sesa të dish të përdorësh vetëm një!